



## ISOGLOSAT E VARIETETEVE GJUHËSORE NË TË FOLMEN E GOSTIVARIT<sup>i</sup>

**Merita Banjica<sup>ii</sup>**

Dr., Faculty of Languages, Cultures and Communication,  
South East European University (SEEU),  
Tetovo, North Macedonia

### **Abstract:**

Në bashkësinë shoqërore të Gostivarit ndërrohen disa bashkësi gjuhësore, ku ndërrohen edhe varietete të ndryshme nga folësit e tyre si të bashkësia gjuhësore shqipe, maqedone, turke, roma, boshnjake, serbe, vlllehe etj. Të gjithë këto varietete të bashkësive gjuhësore janë krijuar si pasojë e migrimit të njerëzve nga vendet rurale në vend urban dhe nga individ të martesave të përziera të ardhur nga vende të ndryshme, që e bartin edhe të folmen e vendit të vet. Metodologjia e hulumtimit ishte me qasje diakronike dhe sinkronike dhe kishte për qëllim të zbulojë disa njësi gjuhësore isoglosa (sinonime), që reflektohen në varietete të ndryshme, prandaj u përdorën disa metoda si metoda historike e teorisë shkencore, metoda empirike, metoda analitike e gjetjeve, metoda cilësore, metoda përgjithësuese. Kampioni i këtij hulumtimi ishte i qëllimshëm, por i rastësishëm, që u realizua më mars 2021 në qytetin e Gostivarit me 24 individ shqiptarë, 15 femra dhe 9 meshkuj. Hulumtimi u zhvillua me pyetësorë të gjysmëstrukturuar me disa intervistuar nga distanca nëpërmjet Microsoft Teams dhe e-mail-ve personale, që përdorin varietete të ndryshme në të folmen e Gostivarit. Ky punim është i përqendruar në tri objektiva:

- të pasqyrojë gjetjet njësisive gjuhësore sipas varieteteve.
- t'i klasifikojë njësisive gjuhësore në tabela sipas pjesëve të ligjëratës.
- t'i pasqyrojë analizën sintetike të njësisive gjuhësore, ku vërehen ndryshime fonetike.

**Fjalët kyçe:** njësia gjuhësore, varietetet, isoglosat, bashkësia gjuhësore, idiolekti, ekologjia gjuhësore

### **Abstract:**

In the social community of Gostivar, several linguistic communities are highlighted, where different varieties of their speakers are also highlighted, such as the Albanian, Macedonian, Turkish, Roma, Bosnian, Serbian, etc. linguistic communities. All these varieties of linguistic communities have been created as a result of the migration of people from rural to urban areas and from individuals of mixed marriages coming from different countries, who also carry the language of their own country. The research methodology was a diachronic and synchronic

<sup>i</sup> ISOGLOSSES OF LANGUAGE VARIETIES IN THE SPEECH OF GOSTIVARI

<sup>ii</sup> Correspondence: email [meritabanjica@yahoo.com](mailto:meritabanjica@yahoo.com)

approach and aimed to discover some isoglossal linguistic units (synonyms), which are reflected in different varieties, therefore several methods were used such as the historical method of scientific theory, empirical method, method of findings, qualitative analytical and generalization method. The sample of this research was intentional, but random, which was carried out in March 2021 in the city of Gostivar with 24 Albanian individuals, 15 women and 9 men. The research was conducted with semi-structured questionnaires with some interviewed remotely via Microsoft Teams and personal e-mails, using different varieties of Gostivar's speech. This work is focused on three objectives: reflect the findings of language units according to varieties; classify language units in tables according to parts of the lecture; reflect the synthetic analysis of linguistic units, where phonetic changes are observed.

**Keywords:** linguistic unit, varieties, isoglosses, linguistic community, idiolect, linguistic ecology

## 1. Hyrje

Në pjesën e parë të këtij punimi ofrohet sqarim teorik gjuhësorë interdisiplinar nga disa aspekte sociolinguistike, morfologjike dhe fonetike-fonologjike. Në pjesën empirike pasqyrohen gjetjet e reflektuara në pyetësorët të gjysmëstrukturuar të përdorur për intervistë me individë të migruar nga qytete të tjera ose nga vende rurale në qytetin e Gostivarit. Njësitë gjuhësore “isoglosat” e varieteve gjuhësore të ndriçuara në pyetësorë pasqyrohen nëpër tabela sipas pjesëve të ligjëratës.

Në vijim bëhet analiza analitike e njësive gjuhësore për t'u vërejtur dukuritë gjuhësore fonetike-fonologjike të paraqitura gjatë evoulimit diakronik të isoglosave. Në pjesën e fundit ndriçohen edhe përfundimet e këtij hulumtimi. Te shtojca jepet sqarimi leksikor i çdo fjale si ndihmesë për humumtuesit plurilingual.

## 2. Vlera e gjuhës

Gjuha është mjet komunikimi shoqëror me vlerë identifikimi individual dhe kolektiv, por edhe dhe me vlerë funksionale se u shërben njerëzve për të kryer aktivitete të ndryshme gjatë përditshmërisë jetësore. Gjuha funksionin e vet e shpreh në çdo komunikim shoqëror duke u mundësuar njerëzve kuptim reciprok gjatë kryerjes së aktiviteteve prodhuese, t'i shprehin nevojate tyre dhe t'i plotëojnë ato, t'i shprehin idetë, t'i shprehin ndjenjat njëri-tjetrit, të pasurojnë kulturën individuale dhe ta shprehin atë në krijimtari të ndryshme.

Gjuha kur përvetësohet nga individë bëhet pronë e tij, e cila bartet në çdo vend, ku ai shkon. Vitaliteti i gjuhës ruhet nga folësit e vet dhe nga folësit e tjerë, që flasin atë gjuhë. Gjuha bëhet e ndryshme, për shkak se lidhet çastin e të folurit (kur flitet) dhe shoqërinë ku flitet. Gjuha përshatet me kontekstin social, prandaj artikullohet nga folësi në mënyrë pragmatike, folësi flet në drejtim të bashkëfolësit në atë varietet gjuhësorë për t'u kuptuar nga bashkëfolësi.

Në bazë të hulumtimeve të bëra në teoritë sociolinguistike, unë “Sociolinguistikën” e definoj: Sociolinguistika është disiplinë gjuhësore, që studion larminë dhe diversitetin e gjuhës në komunikim shoqëror në varësi të pesë variablave kryesore si në kohë, në hapësira,

në klasa shoqërore, në përshtatje të situatave konkrete, në përshtatje pragmatike të idiolektit gjuhësor të folësit në përshtatshmëri me idiolektin gjuhësor të bashkëfolësit.



Figura 1: Diversiteti i gjuhës dhe faktorët ndikues në përhapjen e larmive të ndryshme gjuhësore

## 2.1 Njësia gjuhësore

Njësia gjuhësore është fjala, e cila si pjesë më vogël me kuptim mund të përdoret në varietete të ndryshme të hapësirave të ndryshme shoqërore. Kjo shprehje “njësi gjuhësore” përdoret në fushën e sociolinguistikës si pjesë më e vogël për sqarimin e përdorimit të tyre në varietete gjuhësore, sikur që është njësia leksikore e renditur në një leksikon gjuhësorë (Hudson 2002:33).

## 3. Varietetet gjuhësore

Në sociolinguistikë termi varietet përdoret për të shpjeguar e kuptuar dallimet gjuhësore të gjuhës nga një individ tek tjetri, por edhe dallimet gjuhësore të një grup individësh nga një grup tjetër, të cilët janë anëtarë të një bashkësie të caktuar (Banjica, 2017: 40; Shkurtaaj, 2009:219).

Varietetin e gjuhës sociolinguisti Nordquist, R 2023 e definon si një term të përgjithshëm për çdo formë dalluese të një shprehjeje gjuhësore ose gjuhësore. Në Shoqatën e Oksfordit në Gjuhën Angleze (1992), Tom McArthur identifikon dy lloje të gjera të varieteteve gjuhësore:

- varietete të lidhura me përdorues, të lidhur me njerëz të veçantë dhe shpesh vende;
- varietete të lidhura me përdorimin, të lidhura me funksionin, siç është anglishtja juridike (gjuha e gjykatave, kontratat etj.) dhe anglishtja letrare (përdorimi tipik i teksteve letrare, bisedave etj.) (Nordquist, Riçard, 2023).

Varietete gjuhësore quhen njësitë gjuhësore të ngajshme me përhapje shoqërore të ngajshme. Varieteti gjuhësor bëhet i ndryshëm nga një tjetër në bazë të njësive gjuhësore, që përbëhet. Varietetet mund dallohen në gjuhë të ndryshme me gjuhën standarde, në dialekte të një gjuhe, në nëndialekte dhe në të folmet (regjistra, stile), por gjithë varietetet si të gjitha bëjnë përpjekje të ruajnë qëndrueshmërinë, të mbijetojnë. (Islamaj, 2017; Hudson 2002:33-37).

Ndryshorët sociolinguistikë, që shkaktojnë larminë gjuhësore brenda një bashkësie shoqërore me bashkësi gjuhësore të ndryshme shprehen edhe me të folurit e ndryshëm të së njëjtës gjuhe ose me varietete. Larmitë gjuhësore ndikohen nga disa faktorë, që shprehen në varietete sipas:

- funksioneve-kontekstuale (regjistrat apo stilet e të folurit gjatë kryerjes së aktiviteteve).

- hapësirës gjeografike: dialekteve, nëndialekteve, grupet e të folmeve, të folmet etj.
- faktorëve shoqërorë: mosha, gjinia, arsimimi, profesioni, mjedisi (familje, zyrë, etj.),
- përdorimit të gjuhës standarde në përditshmëri,
- idiolektit të folësit.




Figura 2: Faktorët ndikues në paraqitjen e varieteteve gjuhësore

Varieteti mund të jetë më i gjërë sesa një gjuhë e zakonshme dhe mund të formohet edhe nga gjuhë të ndryshme, që fliten nga një folës ose nga folës së të njëjtës bashkësi në një mjedis të caktuar si në familje, në grup, por ato janë të qëndrueshme në mënyrë natyrore nëpër breza të ndryshëm, prej brezi në brez tjetër deri në atë masë saqë mund të ngatërrohen.

Çdo varietet përcaktohet nga raporti përcaktues me shoqërinë, *kush i përdor* dhe *ku i përdor* njësitë gjuhësore. Në sasinë e varieteteve gjuhësore, që mund të individualizohen në shoqëri nuk ekzistojnë kufijë, por ato mund të kryqëzohen dhe një varietet mund të pëfshijë edhe varietetin tjetër (Hudson 2002:37).

Çdo gjuhë me varietetet e veta ngel vitale vetëm nëse flitet nga folësit e vet dhe të tjerët, që e flasin atë gjuhë. Folësit, kudo që shkojnë varietetin gjuhësor e bartin me vete dhe vazhdojnë ta flasin atje, ku shkojnë, por edhe mund ta kryqëzojnë edhe me ndonjë njësi gjuhësore “isoglos” të varietetit tjetër gjuhësorë në mjedisin, ku vepron dhe flet folësi.

### 3.1 Isoglosat

Isoglosit janë shfaqja e njërive gjuhësore të njëjta (sinonimeve) në disa të folme krahinore (në vende rurale) duke treguar kufij në mes të çdo zone rurale (areale), por me ndonjë ndryshim të vogël në shqiptim të fjalës ose në ndonjë fonemë. Fjala “Isoglos” rrjedh nga greqishtja e vjetër “Iso”, që shqip do të thotë “i barabartë”, kurse “glossa” do të thotë “gjuhë” (Hudson, 2002:49). Çdo shqiptim i isoglose të re paraqet një dukuri në vete, por paraqet edhe nëndarje të varieteteve, ku përdoren.

Isoglosat e kanë përhapjen e vet midis popullsisë së folësve, por përhapja e tyre nuk është identike se ndryshimi i tyre ndikohet nga disa faktorë. Folësit dhe njësitë gjuhësore, që ata i flasin e paraqet edhe ndryshimin ose varietetin, në fakt varieteti nuk ka kufijë dhe nuk ekziston në hapësirë të ndarë. Të folurit e njerëzve me njëri-tjetrin ngjajson sipas përdorimit të njërive gjuhësore në një gjuhë, që janë me kuptim të njëjtë dhe me pak ndryshim në përbërjen fonetike ose me paraqitje të ndryshme (isoglosi) (Bynon, 1977:190 shih:Hudson, 2002:49).

Teoria e valëve shpjegon pse isoglosat ndërpriten, duke kërkuar me ngulm epiqendra gjeografike të ndryshme për përhapjen e njërive të ndryshme, ku çdo dukuri është një risi e

re, që do të thotë isoglosi do të shënojë pikat më të largëta, ku ka mbërritur ndikimi i njësisë së re, në atë periudhë kur një diaktolog i ka mbedhur të dhënat. Çdo qendër përfaqëson burimin e një njësie të re të ndryshme, nga e cila “valët “përhapen në drejtime të ndryshme (Hudson, 2002:51).

### 3.2 Bashkësia gjuhësore

Bashkësi gjuhësore është hapësira shumëdimensionale, ku individët e vendosin veten, dimesionet e së cilës përcaktohen nga grupe, që ata të arrijnë t’i identifikojnë në shoqërinë ku jetojnë. Një fëmijë grupet mund t’i përcaktojë në bazë të seksit, moshës, prejardhjes gjeografike dhe ngjyrës, ku çdo grupim mund të japë një lloj kontributi në kombinimin e veçantë të njësisë gjuhësore, që i zgjedh si gjuhë të vet.

Çdo individ i krijon sistemet e tij verbale në mënyrë të tillë, që ato t’i ngjajnë atyre të grupit ose të grupeve me të cilët herë pas here mund të dojë të identifikohet në atë masë në të cilën:

- ai mund t’i identifikojë grupet,
- ka mundësinë dhe aftësinë t’i vëzhgojë dhe t’i analizojë sistemet e tyre të sjelljes,
- ka motive mjaft të forta që shtynë ta zgjedh dhe ta përshtasë sjelljen e tij sipas së tyre,
- është ende në gjendje ta përshtasë sjelljen e tij (La Page, 1985 shih: Hudson, 2002:36).

Bashkësia gjuhësore krijohet nga folësit e saj, që e adhurojnë duke e përshtatur gjuhën në komunikim shoqëror për gjindshmëri në hapësirë shumëdimensionale dhe funksionale për t’i arritur qëllimet e veta dhe të grupit, me të cilin edhe vetidentifikohen edhe si varietet i veçantë.

### 3.3 Idiolekti, sociolekti dhe ekologjia gjuhësore

Idiolekti është sjellja gjuhësore individuale e folësit, që ndryshon nga një individ tek tjetri. Idiolekti i individit është në varshmëri të madhe nga bashkësia gjuhësore, ku ai fillon ta zhvillojë gjuhën e tij dhe nga bashkësia shoqërore, ku zhvillohet. Çdo varietet i përdorur në mjedisin, ku vepron individi ndikon në idiolektin e tij.

Sociolekti është sjellja gjuhësore e një grupi shoqëror të caktuar, përkatësisht e një kompetence të një grupi shoqëror të caktuar. (Shkurtaj, 2009:64, Gjinari, 2003: 41). Çdo individ të folurit e fillon në familje, kurse zhvillimin sociolingustikë e vazhdon në fis, në lagje, në institucione arsimore, me moshatarë, në studime, në punë, gjatë kohës së lirë pranë mediave etj. Idiolekti e identifikon folësin me varietetin e vet, që dallon nga të tjerët, kurse sociolekti reflekton varietetin e folësit dhe përshtatjen e tij me varietetin, që flitet në mjedisin ku ndodhet.

Ekologjia gjuhësore është përshtatja e folësit biologjikisht me të folmen e mjedist, ku ndodhet. Një folës mund të përdor varietete të ndryshme në mjedise të ndryshme gjatë situatave konkrete, në të cilat ndodhet. Ai mund të flas ndryshe në mbledhje, në xhami ose kishë, në rrugë, në një salon pritjeje, në një tren, në restorant, në shtëpi me anëtarët e familjes, por edhe nëse i afrohet një huaj ndryshe flet me të duke e ndryshuar edhe kodin e gjuhës (në gjuhë tjetër).

## 4. Pjesa Emirike

### 4.1 Metodologjia e hulumtimit

Në qytetin e Gostivarit reflektohen isoglosa të varieteteve gjuhësore të ndryshme, për shkak të migrimit të njerëzve nga vendet rurale në një vend urban dhe nga individ të ardhur nga vende të ndryshme, të cilët e bartin edhe të folmen e vendit të vet.

Hulumtimi socilingustikë me qasje diakronike dhe sikronike u realizua me ndihmën e metodave: historike e teorisë socilinguistike, metodës empirike me intervista të gjysmëstrukturuara, metoda analitike e gjetjeve, metoda cilësore përshkruese, metoda sintetike fonetike - fonologjike, metoda krahasimtare dhe metoda përgjithësuese.

Hipoteza: Në të folmen e Gostivarit reflektohen isoglosi të varieteteve gjuhësore të ndryshme, për shkak se të migrimeve të njerëzve nga viset rurale dhe urbane të tjera në qytetin e Gostivarit.

Kampioni: Kampioni ishte i qëllimshëm, por i rastësishëm, që u realizua më mars 2021 në qytetin e Gostivarit me 24 individ shqiptarë, ku u intervistuan 15 femra dhe 9 meshkuj. Falënderimi për realizimin e intervistave u takon nxënësve të mia Tuhana IX/1, Elzana VII/6, Besa VIII/6, Ramie VIII/6, Suada IX/6, Ajshe IX/5, Lule IX/3, që më ndihmuan përmes Microsoft Teams ta zhvilloj këtë intervistë me anëtarët e familjeve të tyre, por gjithashtu edhe të intervistuarëve të tjerë, që u intervistuan nëpërmjet të e-mailit duke reflektuar disa isoglosi.

**Tabela 4.1.** Kampioni i të intervistuarëve

Emri dhe mbiemri	Mosha	Seksi	Vendbanimi	Fshati nga vjen	Qyteti nga vjen
1) S., Hajrullai	35 vjeçe	Femër	Gostivar	Reçan	
2) B., Hajrulli	45 vjeç	Mashkull	Gostivar	Sërbinovë	
3) T., Hajrullai	15 vjeçe	Femër	Gostivar	Reçan-Sërbinovë	
4) E., Mazllami	38 vjeç	Mashkull	Gostivar	Nistrovë	
5) M., Mazllami	38 vjeçe	Femër	Gostivar	Nistrovë	
6) E., Mazllami	14 vjeçe	Femër	Gostivar	Nistrovë	
7) K., Seferi	49 vjeç	Mashkull	Gostivar-Zdunjë	Nistrovë	
8) L., Sulejmani	51 vjeçe	Femër	Gostivar-Zdunjë	Duf	
9) Xh., Hajdari	47 vjeç	Mashkull	Gostivar	Kalishtë	
10) L., Hajdari	53 vjeçe	Femër	Gostivar	Duf	
11) S., Hajdari	15 vjeçe	Femër	Gostivar	Kalishtë-Duf	
12) E., Sulejmani	60 vjeç	Mashkull	Gostivar	Tanushë-Duf	
13) B., Kasami	30 vjeçe	Femër	Gostivar-Zdunjë	Kalishtë	
14) N., Amzai	38 vjeçe	Femër	Gostivar	Debresh	
15) L., Muhtari	42 vjeç	Mashkull	Gostivar		Kukësi
16) E., Fejzullahu	45 vjeçe	Femër	Gostivar		Peshkopi
17) L., Fejzullahu	50 vjeç	Mashkull	Gostivar	Raven-Reçan	Peshkopi-Raven
18) L., Fejzullahu	15 vjeçe	Femër	Gostivar		
19) I., Abazi	19 vjeçe	Femër	Gostivar	Toplicë	
20) K., Fetai	15 vjeçe	Femër	Gostivar	Tanushë	
21) E., Ismaili	45 vjeç	Mashkull	Gostivar	Nistrovë	
22) Rexhepi, R.	50 vjeçe	Femër	Gostivar	Duf	
23) B., Ismaili	30 vjeç	Mashkull	Gostivar	Rekë	
24) A., Myftari	15 vjeçe	Femër	Gostivar		Kukës

Gjetjet të cilat u ndriçuan në pyetësorët të gjysmëstrukturuar i pasqyrojmë në tabela për t'i klasifikuar të gjithë fjalët sipas pjesëve të ligjëratës. Në gjetjet e këtij hulumtimi u ndriçuan disa lloje të fjalëve: 63 emra, 1 mbiemër, 2 përemra, 3 folje, 3 ndajfolje, 3 numëror, dy pjesëza dhe 8 fjali pyetëse dhe nxitëse. Gjatë intervistave nga të intervistuarit u ndriçuan isoglosa të varieteteve gjuhësore sipas të folmeve të mjedisit, por u reflektuan edhe isoglosat e varietetit standard.

Ndoshta do të kishte qenë më mirë, që nga ana e hulumtuesit (nga unë) të përcaktoheshin më tepër fjalë sipas varietetit standard, mirëpo qëllimi ishte të zbulohet edhe përvetësimi i varietetit standard nga të intervistuarit, Isoglosat e varietetit standard të reflektuara gjatë intervistës janë tregues se të gjithë të intervistuarit e kanë përvetësuar varietetin standard si meritë e zbatimit të të gjuhës shqipe standarde në institucione arsimore.

Në hulumtim u përfshin individ të grup-moshave të ndryshme, që janë tregues se isoglosat e varieteteve gjuhësore barten prej brezi- në brez duke u folur nga të gjithë anëtarët e familjeve, që i përceptojnë ato njësi gjuhësore. Termet u sqaruan sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe.

## 4.2. Gjetjet e isoglosave të ndriçuara gjatë intervistave

**Tabela 4.2:** Isoglosat e emrave të varieteteve të ndryshme të ndriçuara në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
1. Nënë	Emër	Nona	Dad	Dad	Dad	Non	Ane	Nana	Nana	Nona
2. Baba	Emër	Baba	Lal	Lal	Lal	Bab	Babi	Baba	Baba	Baba
3. Djalë	Emër	Gjalë	Gjali	Gjali	Djalo	Gjal	Gjal	Çun	Voc	Djalë
4. Vajzë	Emër	Vajzë	Vajzë	Vajzë	Vajzë	Couc	Cucë	Goc	Cuc	Couc
5. Xhaxha	Emër	Minxhë	Mixhë	Mixhë	Mixhë	Minxhë	Xhuli	Axha	Mixhë	Minxhë
6. Mësues	Emër	Msus	Msus	Msus	Msus	Msus	Msus	Mësues	Msues	Msus
7. Mik	Emër	Mejk	Mik	Mik	Mik	Mejk	Mejk	Mik	Mik	Mejk
8. Qytet	Emër	Sherr	Shehër	Shehër	Shehër	Sherr	Shehër	Qytet	Qytet	Sherr
9. Fshat	Emër	Katund	Katund	Katund	Katund	Katound	Katund	Fshat	Fshat	Katund
10. Shtëpi	Emër	Shpeja	Shpi	Shpi	Shpi	Shpaja	Shpej	Shpia	Shtëpi	Shpej
11. Spital	Emër	Bollnejc	Bolnic	Bolnic	Bolnic	Bollnejc	Bolnicë	Spital	Spital	Bolnic
12. Banjo	Emër	Kupatillë	Hamom	Kupatill	Hamom	Kupatillë	Kupatillë	Banjo	Banjo	Kupatillë
13. Dritare	Emër	Xhami	Penxhere	Penxhere	Xhom	Xhomi	Xhom	Dritare	Dritare	Xhom
14. Kasollë	Emër	Mashna	Kasoll	Mutfak	Mashën	Mashën	Mutfak	Mashën	Kasolle	Mashën
15. Ahur	Emër	Qurr	Mashën	Mashën	Qurr	Arë	Ahur	Ahur	Quhur	Qurr
16. Divan	Emër	Kauç	Kauç	Kauç	Kauç	Kauç	Kauç	Divan	Divan	Kauç
17. Dollap	Emër	Shifunjer	Dallap	Dallap	Dallap	Dollap	Dollap	Dollap	Dollap	Dollap
18. Frigorifer	Emër	Frizhider	Frizhider	Frizhider	Frizhider	Frizhider	Frizhider	Frigorifer	Frigorifer	Frizhider
19. Shporet	Emër	Qimbet	Sobë	Sobë	Sobë	Shporet	Shporet	Shporet	Soba	Shporet
20. Tavolinë	Emër	Sofër, Astall	Astall	Astall	Astall	Astall	Astall	Tavolinë	Tavolinë	Astall
21. Karrige	Emër	Sandlije	Stolic	Stolic	Stolic	Sotlicë	Karrike	Karrike	Karrike	Sandalije
22. Qilim	Emër	Tepik	Tepik	Tepik	Tepih	Halie	Qilim	Tepik	Qilim	Tepik
23. Peshqir	Emër	Marhom	Marhom	Marhom	Marhom	Peshkir	Marhom	Peshkir	Peshqir	Marhom
24. Pasqyrë	Emër	Bafçire	Pashjyr	Pashqyre	Pashqyre	Bafçire	Bafçire	Pasqyre	Pasqyrë	Bafçire
25. Llambë drite	Emër	Sijalicë	Sijalic	Lambë	Lambë	Sijalicë	Sijalicë	Dritë	Dritë	Sijalic
26. Çezma	Emër	Çeshma	Kroi	Kroi	Kroi	Çeshma	Çeshme	Çeshme	Çezma	Çeshme
27. Telekomnadë	Emër	Digitron	Digitron	Digitron	Digitron	Digitron	Digitron	Digitron	Telekomandë	Digitron
28. Orë	Emër	Saat	Sahat	Sahat	Sahat	Sahat	Sahat	Orë	Orë	Sahat
29. Celular	Emër	Mobil	Telefon	Telefon	Telfon	Telefon	Telefon	Celuar	Celular	Telefon
30. Kuletë	Emër	Kuletër	Gjyzdan	Gjyzdan	Gjyzdan	Kulet	Kuleter	Kuletër	Portofol	Kuletër



Merita Banjica  
ISOGLOSSES OF LANGUAGE VARIETIES IN THE SPEECH OF GOSTIVARI

31. Xhaketë	Emër	Pallto	Palltë	Pallt	Pallt	Pallt	Jakett	Xhaket	Xhaket	Pallto
32. Stilplapsi	Emër	Penkall	Penkall	Penkall	Penkall	Mastill,	Penkall	Stilograf	Stilograf	Penkall.
33. Gjilpërë	Emër	Xhilpon	Zhylpon	Zhylpon	Zhylpon	Xhilpon	Xhilpon	Gjilpon	Gjilpërë	Xhilpon
34. Gotë	Emër	Shihe	Çashë	Çashë	Çashë	Sërçe	Sërçe	Gotë	Gotë	Sërçe
35. Pluhur	Emër	Pjun	Pquhun	Pquhun	Pjuhun	Pjun	Pjun	Pluhur	Plur	Pjun
36. Syri	Emër	Sëjni	Syni	Syni	Syni	Sajni	Sejni	Syni	Syri	Sejni
37. Oborr	Emër	Bafçe	Avli	Kurt	Kurt	Lomë	Avlli	Oborr	Oborr	Bafçe
38. Dhe	Emër	Troulli	Truell	Troulll	Dhe	Troull	Traulli	Troulli	Dhe	Troull
39. Baltë	Emër	Balt	Baltë	Lloç	Lloç	Lloç	Balt	Balt	Baltë	Balt
40. Saksi	Emër	Garoç	Cafkë	Safë	Safë	Shutar	Saksi	Saksi	Vazë	Saksi
41. Makinë	Emër	Çere	Limuzinë	Limuzinë	Limuzinë	Çere	Çere	Veturë	Makinë	Çere
42. Borë	Emër	Vdor	Vdor	Vdor	Vdor	Vdor	Vdor	Vdor	Borë	Vdor
43. Shi	Emër	Shëej	Shi	Shi	Shi	Shai	Shqi	Shi	Shi	Shëj
44. Kanal	Emër	Jaz, Proi	Proi	Proi	Proi	Kanal	Kanal	Kanal	Kanal	Kanal
45. Diell	Emër	Dill	Dill	Dill	Dill	Dill	Dill	Diell	Diell	Dill
46. Vetëtimë	Emër	Vektejm	Arfe	Vektijm	Faktejm	Faktejm	Vektejm	Vektejm	Vetëtimë	Vektejm
47. Tym	Emër	Tajmi	Tim	Tim	Tajmi	Tejmi	Tejm	Tejm	Tymi	Tejm
48. Qeni	Emër	Çeni	Sheni	Sheni	Sheni	Çeni	Çeni	Qeni	Qeni	Çeni
49. Gështenjë	Emër	Kshtenj	Kashta	Kashtenj	Kahstenj	Gështejnë	Gështenjë	Gështenjë	Gështenjë	Gështenj
50. Gjeth	Emër	Xheth	Zhethi	Zhethi	Zhethi	Xheth	Xheth	Xheth	Gjeth	Xheth
51. Miell	Emër	Mëjll	Miell	Miell	Mill	Mejll	Mejll	Miell	Miel	Mejll
52. Misër	Emër	Mçenk	Mçenk	Mçenk	Mqenk	Kallamboç	Kallej	Misër	Misër	Mçenk
53. Groshë	Emër	Grosh	Pasul	Grosh	Grosh	Grosh	Groshë	Groshë	Groshë	Groshë
54. Patate	Emër	Kompir	Repa	Repa	Repa	Kompir	Kompira	Kompira	Patate	Kompir
55. Domate	Emër	Patlixhon	Patlixhan	Patlixhan	Patlixhan	Patlixhon	Patlixhon	Domate	Domate	Patlixhon
56. Specë	Emër	Piprika	Piprika	Piprika	Piprika	Specë	Specë	Specë	Specë	Piprika
57. Kripë	Emër	Krejp	Kryp	Kryp	Kryp	Krejp	Krejp	Krip	Kripë	Krejp
58. Qersh	Emër	Çarsheja	Shushi	Shyrqi	Shurqi	Qersh	Çërshija	Qersh	Qersh	Çërshëj
59. Dredhëz	Emër	Jagoda	Dresa	Dresa	Dresa	Lagoda	Jagoda	Dredhëz	Luleshtrudhe	Lagoda
60. Shalqi	Emër	Karpuz	Bostan	Lubenicë	Lubenicë	Karpuz	Karpuz	Shalqir	Shalqi	Karpuz
61. Pilaf	Emër	Pilaf	Jufka	Jufka	Jufka	Pilaf	Pilaf	Pilaf	Jyfka	Pilaf
62. Çam-Çakëz	Emër	Mastik	Mastik	Mastik	Mastik	Zhvakaç	Mastikë	Sakëz	Çam-Çakëz	Mastik
63. Qumësht	Emër	Tomël	Tombël	Tomël	Tomël	Tomël	Tomël.	Tomël	Qumësht	Tomël

**Tabela 4.3:** Isoglosat e mbiemrave të varieteteve të ndryshme të ndriçuara në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
I bukur	Mbiemër	I hishët	I hishun	I hishët	I hishët	I hejshëm	I hijshëm	I bukur	I bukur	I heshët

**Tabela 4.4:** Isoglosat e përemrave të varieteteve të ndryshme të ndriçuara në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
Ti	Përemër	Tej	Ti	Ti	Ti	Tej	Tej	Ti	Ti	Tej
Çfarë?	Përemër pyetës	Çish?	Ki?	Ki?	Ki?	Ki?	Çish?	Çfarë?	Çish?	Çish?

**Tabela 4.4:** Isoglosat e foljevetë varieteteve të ndryshme të ndriçuara në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
Prit!	Folje	Prejt!	Prit!	Prit!	Prit!	Prajt!	Prejt	Prit	Prit	Prejt!
Hesht!	Folje	Troku!	Trait!	Trait!	Trait!	Truku!	Ndalu	Hesht	Pusho	Ndalu!
Nervozohet	Folje	Këzdiset	Kizdiset	Këzdiset	Këzdiset	Nervozohet	Këzdis	Nervozohet	Nevrikoset	Nervozohet

**Tabela 4.5:** Isoglosat e ndajfoljeve të varieteteve të ndryshme të ndriçuara në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
Pastaj	Ndaj.kohe	Ani	Ani	Ani	Anit	Mrapa	Mamprapa	Pastaj	Pastaj	Mrapa
Lart	Ndaj. vendi	Nalt	Nalt	Rma	Rma	Terma	Nalt	Lart	Lart	Nolt
Mirë	Ndaj. mënyre	Mejr	Mirë	Mirë	Mirë	Mejr	Mejr	Mirë	Mirë	Mejr

**Tabela 4.6:** Isoglosat e numërorëve të varieteteve të ndryshme të ndriçuara në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
Një	Numëror	Njo	Njo	Njo	Njo	Nji	Njo	Nji	Një	Njo
Tre	Numëror	Tri	Tri	Tri	Tri	Tre	Tre	Tre	Tre	Tre
Gjashtë	Numëror	Xhash	Zhashtë	Zhashtë	Zhashtë	Xhashë	Xhashë	Gjashë	Xhashtë	Xhasht

**Tabela 4.7:** Isoglosat e pjesëzave të varieteteve të ndryshme të ndriçuar në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Pjesë e ligjëratës	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Kukësit	E folmja e Peshkopisë	E folmja e Sërbinovës
Jo, Nuk	Pjesëz mohuese	Nouk	Ja nuk	Nuk	Nouk	Nauk	Nouk	Jo	Nuk	Nauk
Ja	Pjes. përforcuese	Çe	Lla	La	La	Çe	Çe	Ja	Çe	Çe

**Tabela 4.8:** Isoglosa të fjalive të varieteteve të ndryshme të ndriçuar në të folmen e Gostivarit

Gjuhë letrare	Fjali	E folmja e Reçanit	E folmja e Nistrovës	E folmja e Dufit	E folmja e Tanushës	E folmja e Kalishtës	E folmja e Debreshit	E folmja e Sërbinovës
Eja këtu!	Fjali nxitëse	Ija ktu!	Hec ktu!	Ea kho!	Eja kho!	Hec ktu!	Hec ktou!	Hec teko!
Shih atje!	Fjali nxitëse	Shejf aqe!	Shih aqe!	Zhgja aqe!	Zhgja aqe!	Çëlo aqe!	Shejf atje!	Shejf aqe!
Largohu prej këtu!	Fjali nxitëse	Shporu prej ktu!	Çporu prej ktu!	Ik pi ktu!	Ik prej aqe!	Hupu pi ktu!	Shko pi ktou!	Shko pi ktu!
Mos më shiko!	Fjali nxitëse!	Mos mshif!	Mas mshih!	Ma mzhgja!	Mo mzhgja!	Mom çolo!	Mo m'shejf !	Mo m'shejf!
Çfarë je duke folur?	Fjali pyetëse	Çish je tu fol?	Ki je tu folun?	Ki je to fol?	K'folën?	Far flet?	Çish ie t'u folë!	Çi ije t'u fol?
A do të shkosh në shtëpi?	Fjali pyetëse	A do shkojsh nshpi?	A da shkojsh n'shpi/doma?	A da shkosh n' shpi!	A da shkojsh n' shpi?	A do shkosh n' shpaj?	A do shkojsh n' shpej!	A do shkojsh n' shpej?
A je mire?	Fjali pyetëse	A je mëjr?	A je mirë	A je mire!	A je mire?	A ie mejr?	A ie mejr?	A ije mejr?
Çfarë bën?	Fjali pyetëse	Çish bon?	Gbon?	Gbon?	G'bon?	Çar bon?	Çish bon!	Çish bon?

### 4.3 Njësitë gjuhësore të varietetit standard dhe isoglosat në të folmen e Gostivarit

Hulumtimi diakronik për përdorimin e isoglosave në qytetin e Gostivarit i realizuar me anë të intervistave me folës të rastësishëm ndriçoi se njësitë gjuhësore të varietetit standard fliten nga të gjithë të intervistuarit, por u ndriçuan edhe isoglosa të varieteteve gjuhësore të ndryshme, që janë tregues se përcjellja e isoglosave prej brezi pas brezi është proces i pandërprerë i të gjithëve sipas varietetit, që e flasin folësit dhe sipas sociolektit, që i takojnë. Në vijim i paraqesim njësitë gjuhësore të varietetit standard dhe isoglosat, që gjithsej janë 63 emra dhe 14 pjesë të tjera të ligjëratës:

- 1) Njësia gjuhësore “nënë” te folësit e varietetit të Dufit, Nistrovës dhe Tanushës përdoret isoglosi “dadë”, ndërsa te folësit e varietetit të Debreshit përdoret isoglosi “ane”.
- 2) Njësia gjuhësore “baba” te folësit e varietetit të Dufit, Nistrovës dhe Tanushës përdoret isoglosi “lal”, kurse te folësit e varietetit të Debreshit përdoret isoglosi “babi”.
- 3) Njësia gjuhësore “djalë” te folësit e varietetit të Kukësit përdoret isoglosa “çun”, kurse te folësit e varietetit të Peshkopisë përdoret isoglosi “voc”.
- 4) Njësia gjuhësore “vajzë” te folësit e varietetit të Kalishtës përdoret isoglosi “couc”, te folësit e varietetit të Debreshit përdoret isoglosa “cucë”, ndërsa te folësit e varietetit të Kukësit përdoret isoglosi “goc” dhe te folësit e varietetit të Peshkopisë “cuc”.
- 5) Njësia gjuhësore “xhaxha” përdoret te folësit varieteti i Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Peshkopisë dhe Sërbinovës isoglosi “mixhë-minxhë”, kurse te folësit e varietetit të Debreshit isoglosi “xhuli” dhe te varieteti i Peshkopisë isoglosi “axha”.
- 6) Njësia gjuhësore “mësues” te folësit e varietetit të Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit dhe Sëerinovës përdoret isoglosi “msus”, kurse te folësit e varietetit të Kukësit isoglosi “mësues”, ndërsa te varieteti i Peshkopisë përdoret isoglosi “msues”.
- 7) Njësia gjuhësore “mik” përdoret te folësit e varietetit të Reçanit, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës si isoglosi “mejk”, kurse te folësit e varietetit të Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “mik”.
- 8) Njësia gjuhësore “qytet” përdoret te folësit e varietetit të Reçanit, Kalishtës dhe Sërbinovës isoglosi “sherr”, kurse te varieteti i Nistrovës, Dufit, Tanushës dhe Debreshit përdoret isoglosi “sheher” dhe te varieteti i Kukësit dhe Peshkopisë përdoret “qytet”.
- 9) Njësia gjuhësore “fshat” përdoret te folësit e varietetit të Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Debreshit dhe Sërbinovës si isoglosi “katund”, kurse te varieteti i Kalishtës përdoret isoglosi “katound” me shtim të zanores “o” duke formuar grup zanorësh “ou”, kurse te folësit e varietetit të Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “fshat” .
- 10) Njësia gjuhësore “shtëpi” përdoret të varieteti i Reçanit, Kalishtës dhe Sërbinovës si isoglosi “shpeja”, te folësit e varietetit e Nistrovës, Dufit, Tanushës përdoret reduktim i njësisë gjuhësore prej pesë fonemeve “shpeja” në tri fonema “shpi”, kurse te varieteti i Kukësit përdoret isoglosi “shpia”, te varietetit të Peshkopisë përdoret isoglosi “shtëpi”.
- 11) Njësia gjuhësore “spital” te varieteti i Reçanit, Kalishtës përdoret si isoglosi “bollnejc”, kurse te varietetet e Nistrovës, Dufit, Tanushës, Debreshit dhe Sërbinovës përdoret

- isoglosi “bollnic”, te folësit e varieteti të Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “spital”.
- 12) Njësia gjuhësore “banjo” te folësit e varietetit të Reçanit, Dufit, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës “kapatillë”, kurse te varietetit i Nistrovës, Tanushës isoglosi “hamamhamom”, kurse te varieteti i Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “banjo”.
  - 13) Njësia gjuhësore “dritare” përdoret isoglosi “xhami-xhom” në varietetin e Reçanit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës, kurse te varieteti i Kukësit dhe Peshkopisë përdoret “dritare” dhe te varieteti i Nistrovës, Dufit përdoret “penxhere”.
  - 14) Njësia gjuhësore “kasollë” përdoret në varietetin e Reçanit, Tanushës, Kalishtës, Kukësit dhe Sërbinovës si isoglosi “mashën”, kurse në varietetin e Nistrovës dhe Peshkopisë dhe Kukësit përdoret isoglosi “kasoll-kasolle” dhe te folësit e varietetit të Dufit dhe Debreshit përdoret isoglosi “mutfak”.
  - 15) Njësia gjuhësore “ahur” përdoret në varietetin e Reçanit, Tanushës, Sërbinovës si isoglosi “qurr”, kurse në varietetin e Peshkopisë si isoglosi “quhurr”, kurse në varietetin e Nistrovës, Dufit përdoret isoglosi “mashën”, ndërsa në varietetin e Kalishtës përdoret isoglosi “arë” dhe te folësit e varietetit të Debreshit dhe Kukësit përdoret isoglosi “ahur”.
  - 16) Njësia gjuhësore “divan” përdoret në varietetin e Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës si isoglosi “kauç”, kurse në varietetin e Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “divan”.
  - 17) Njësia gjuhësore “dollap” përdoret te varieteti i reçanit përdoret isoglosi “shifunjer”, ndërsa te varieteti i Kalishtës, Debreshit, Kukësit, Peshkopisë dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “dollap”, kurse te varieteti i Nistrovës, Dufit, Tanushës përdoret isoglosi “dallap”, ku vërehet se zanorja “o” ndërrohet në “a” .
  - 18) Njësia gjuhësore “frigorifer” përdoret te varieteti i Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës si isoglosi “frizhider”, kurse te folësit me preardhje nga e folmja e Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “frigorifer”.
  - 19) Njësia gjuhësore “shporet” përdoret te varieteti i Reçanit si isoglosi “qimbet”, kurse varieteti i Nistrovës, Dufit, Tanushës dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “sobë”, ndërsa te varieteti i Kalishtës, Debreshit, Kukësit dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “shporet”.
  - 20) Njësia gjuhësore “tavolinë” përdoret te varieteti i Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës si isoglosi “astall”, kurse te varieteti i Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “tavolinë”.
  - 21) Njësia gjuhësore “karrige” përdoret te varieteti i Reçanit dhe Sërbinovës si isoglosi “sandalije”, kurse te varieteti i Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës përdoret isoglosi “stolicë”, kurse te varietetit i Debreshit, Kukësit përdoret isoglosi “karrike, kurse te varieteti i Peshkopisë përdoret isoglosi” karrige”.
  - 22) Njësia gjuhësore “qilim” përdoret te varieteti i Reçanit, Nistrovës, Dufit, Kukësit, Sërbinovës si isoglosi “tepiq”, ndërsa te varieteti i Tanushës përdoret isoglosi “tepih”, ndërsa te varieteti i Kalishtës përdoret isoglosi “halie” dhe te folësit e varietetit të Debreshit përdoret isoglosi “qilim”.
  - 23) Njësia gjuhësore “peshqir” te folësit e varietetit të Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Debreshit dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “marhom”, kurse te folësit e varietetit të

- Kalishtës dhe Kukësit përdoret isoglosi “peshkir”, ndërsa te folësit e varietetit të Peshkopisë isoglosi “peshqir”.
- 24) Njësia gjuhësore “pasqyrë” te folësit e varietetit të Reçanit, Kalishtës dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “bafçire”, kurse te varieteti i Nistrovës përdoret isoglosi “pashjyr”, te te varieteti i Dufit, Tanushës përdoret isoglosi “pashqyre”, kurse te varieteti i Peshkopisë dhe Kukësit përdoret isoglosi “pasqyre”, ndërsa te varieteti i Debreshit përdoret “bafçire”.
- 25) Njësia gjuhësore “dritë” te folësit e varietetit të Reçanit, Nistrovës, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “sijalicë”, kurse te folësit e varietetit të Dufit dhe Tanushës përdoret isoglosi “llambë”, ndërsa te folësit e varietetit të Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “dritë”.
- 26) Njësia gjuhësore “çezma” te folësit e varietetit i Reçanit, Kalishtës Debreshit, Kukësit dhe Sërbinovës përdoret isoglosi si “çeshma”, kurse te folësit e varietetit të Nistrovës, Dufit dhe Tanushës përdoret isoglosa “kroi”.
- 27) Njësia gjuhësore “telekomandë” te folësit e varietetit i Reçanit, Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit, Kukësit dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “digitron”, kurse te folësit e varietetit të Peshkopisë përdoret isoglosi “telekomandë”.
- 28) Njësia gjuhësore “orë” te folësit e varietetit të Reçanit përdoret isoglosi “saat”, kurse te folësit e varietetit të Nistrovës, Dufit, Tanushës, Kalishtës, Debreshit dhe Sërbinovës përdoret isoglosi “sahat” dhe te folësit e varietetit të Kukësit dhe Peshkopisë përdoret isoglosi “orë”.
<p><b>ÇAMÇAKËZ</b> <i>m. (chewing gum)</i></p> <p>1. Lëndë e ngurtë, e verdhë dhe e tejdukshme, që nxirret nga rrëshira e drurëve halorë dhe që përdoret për ngjitje, për izolim dhe për të fërkuar harqet e veglave me tela. Çamçakëz për violinë. Bëj (fërkoj) me çamçakëz. Nxjerr çamçakëz.</p> <p>2. ~Ë, ~ËT. Lloj gome e përzier me një lëndë me erë të mirë dhe me sheqer, që mbahet në gojë për ta përtypur. Një copë çamçakëz. Përtyp (mbaj në gojë) çamçakëz.</p>
<p><b>ÇEZMË</b> <i>f. (drinking fountain)</i></p> <p>Gyp a lug nga ku rrjedh ujë i pijshëm, që vjen prej ujësjellësit ose prej një burimi të mbuluar; burim i mbuluar, nga ku uji rrjedh nëpër një gyp. Çezmë e ftohtë. Çezmë e njomë çezmë që ka ujë gjithnjë. Çezmë e thatë çezmë që shteron gjatë verës. Çezmat e fshatit. Ujë çezme. Pi në çezmë. Mbush ujë në çezmë.</p>
<p><b>DIVAN</b> <i>I m. (sofa)</i></p> <p>1. Kanape e gjerë dhe e gjatë si shtrat, me susta a me sfungjer dhe e veshur si kolltuk, që shërben për të ndenjur ose për t'u shtrirë; shtrat i ngushtë anës murit të dhomës, ku mund të ulemi ose të shtrihemi. Divan me raft. Hap divanin. Ulet (shtrihet) në divan. Fjeti në divan.</p> <p>2. Korridor i gjerë, zakonisht në katin e dytë të një shtëpie, ku dalin dyert e dhomave, paradhomë, mesore.</p> <p>3. Ballkon i mbuluar në hyrje të shtëpisë ose në katin e dytë. Doli në divan. Hanin bukë në divan. ...</p>
<p><b>DIELL</b> <i>m. (sun)</i></p> <p>1. edhe astr. Trupi i zjarrtë qiellor që gjendet në qendër të sistemit tonë planetar dhe që është burim drite e ngrohtësie. Drita (ngrohtësia, energjia) e diellit. Rrezet e diellit. Lindja e diellit. Perëndimi i diellit. Eklipsi i Diellit. Njollat e Diellit. Rrotullimi i Tokës rreth Diellit.</p> <p>2. Drita dhe ngrohtësia që lëshon ky trup qiellor; rrezet e këtij trupi qiellor. Diell i ngrohtë (përvëlues, i nxehtë, i fortë, verbues). Dielli pranveror. Dielli i mëngjesit. Diell me dhëmbë diell që shkëlqen, po nuk ngroh; diell dimri. Banja dielli. Çadër (kapelë) dielli. Syze dielli syze me xhama të errët, që përdoren për të mbrojtur sytë nga drita e fortë e diellit. Ditë me diell. ....</p> <p>3. Vend që e rrahin rrezet e këtij trupi qiellor; kund. hije. Nxjerr (qit, vë) në diell. E la në diell. Dal (thahem) në diell. Rrinte (fliste, ngrohej) në diell. U thek në diell.</p> <p>4. fig. Diçka që është burim jete e të mirash materiale, burim përparimi, gëzimi ... Dielli i jetës sonë.</p> <p>5. edhe ~J, ~JT astr. Trup i madh qiellor që ndodhet në qendër të një sistemi planetar. Diejt fqinjë.,,,,,,</p>

<p>DJALË <i>m. (boy)</i></p> <p>1. Fëmijë mashkull deri në moshën e pjekurisë; njeri i seksit mashkullor në moshë të re e i pamartuar. Djali i vogël (i ri, i bukur). Djalë trim (punëtor, i urtë, azgan). Djalë i prapë. Djemtë e klasës. Veshje për djem.....</p> <p>2. Fëmijë mashkull kundrejt prindërve të vet, i biri i dikujt. Djali i vogël (i madh, i mesëm). Djali ynë. Djalë i vetëm. Djali i parë (i dytë). Djali i shtëpisë. Djali i pleqërisë djali më i vogël me të cilin zakonisht .</p> <p>3. Njeri shumë më i ri në moshë kundrejt një më të vjetri, ai që quhet prej dikujt si i ri; ai që s'e ka përvojën e duhur .....Është ende djalë. Ti, djalë, mos u rrëmbe!</p> <p>4. fig. Njeri trim, i zoti e luftëtar; burrë, trim. Djemtë e maleve. ...</p> <p>5. Qytetar i denjë i një vendi a i një populli ose pjesëtar aktiv i një kolektivi, i një organizate etj., që është rritur e edukuar në gjirin e tyre dhe që mbron interesat e tyre; bir. Djemtë e popullit, e fshatit, e malësisë.</p>
<p>DOLLAP <i>m. (CLOSET)</i></p> <p>1. Orendi me përmasa të ndryshme, që është si një arkë e vendosur me këmbë e zakonisht me dy kanate dhe që shërben për të vënë brenda rroba, ushqime a sende të tjera. Dollap i madh (i vogël). Dollap druri (hekuri). Dollap buke (rrobash). Dollapi i enëve. Dollap me xham (me rrjetë teli). Dollap në mur. Hap (mbyll) dollapin. Vë (mbaj) në dollap.....</p>
<p>DOMATE <i>f. (TOMATO)</i></p> <p>Bimë barishtore njëvjeçare, e cila mbillet në pranverë e bën kokrra të mëdha që piqen në fillim të verës dhe kanë ngjyrë të kuqe; kokrra e kësaj bime që përdoret si ushqim. Domate të kuqe. Domate të bardha domate të papjekura. Domate të hershme (të vona). Domate kumbullore domate e vogël e gjatoshë. Domate të mbushura. Fara e domates. Salcë (lëng) domatesh. Sallatë me domate. Vrugu i domates.....</p>
<p>DREDHËZ <i>f. bot. (STRAWBERRY)</i></p> <p>1. Luleshtrydhe. Dredhëza të pjekura. Reçel dredhëzash.</p> <p>2. Dredhkë. Shkul dredhëzat.</p> <p>3. Urth. Mur i mbuluar me dredhëza.</p> <p>4. Dredhë hardhie etj. Ka nxjerrë dredhëza. Është kapur me dredhëza.</p>
<p>DRITARE <i>f. (WINDOW)</i></p> <p>Pjesë e hapur në murin e një ndërtese, në vagonët e trenit, në kabinat e anijeve etj., nga e cila hyn drita dhe ajri ose nëpërmjet së cilës shohim jashtë; korniza me xhame që mbyll këtë të hapur. Dritare të mëdha (të vogla). Dritare katrore (katërkëndëshe, të rrumbullakëta). Dritaret e automobilin (e trenit...). Dritarja e vendstrehimit. Xhamet e dritares. Kanatet (fletët) e dritares. Pezuli i dritares. Perdet e dritares. Dhomë me dy dritare. Hap (mbyll) dritaren. Rri (del) në dritare. Shikon nga dritarja. E hodhi (e flaku) jashtë nga dritarja.....</p>
<p>DHE <i>m. sh (EARTH)</i></p> <p>1. Korja e rruzullit tokësor në tërësinë e saj a në një pjesë të caktuar; shtresa e sipërme e kësaj koreje; lëndë e ftë a e shkrifët që përben koren e rruzullit tonë; tokë. Dhe i bardhë (i kuq, i zi, i verdhë, i hirtë). Dhe i ngjeshur (i shkrifët, i fortë, i rrahur, i hedhur). Shkarjet (shembjet) e dheut. Grumbull (pirg) dheu. Enë dheu. Digë dheu. Ngjyrë (bojë) dheu ngjyrë</p>

<p>e murrme, me të përhimë. Punime dheu. Mbi (nën) dhe. Heq (mblodhi) dheun. Qëroj dheun me lopatë.</p> <p>2. vet. nj. Trualli ku qëndrojnë a lëvizin njerëzit, kafshët etj., Ra në dhe. Ulem në dhe.....</p>
<p>FRIGORIFER <i>m.</i> (<i>freezer</i>)</p> <p>1. Dollap ose dhomë me një aparaturë të posaçme ftohëse, ku ruhen në gjendje të freskët ose të ngrirë ushqime të ndryshme si mishi, bulmeti, pemët, perimet etj. Frigorifer shtëpie. Frigoriferi i ndërmarrjes ushqimore (i mishit).</p>
<p>FSHAT <i>m.</i>- (malor) VILLAGE</p> <p>1. Fshat i largët. Fshatrat e Shkodrës (e Beratit). Kroi i fshatit. Shtëpi fshati. Shkoj (punoj, jetoj) në fshat. Ngushtimi i dallimeve midis fshatit dhe qytetit.</p> <p>2. përmb. Tërësia e banorëve të kësaj qendre; fshatarët. U mblodh (u ngrit) i gjithë fshati.</p> <p>3. Qendër e vogël ku banojnë përkohësisht grupe njerëzish që kryejnë një veprimtari të caktuar. Fshat olimpik.....</p>
<p>GËSHTENJË <i>f.</i> (CHESTNUT)</p> <p>1. gështenja.</p> <p>2. përd. mb. bised. Që ka ngjyrë kafe të errët në të kuqërreme si ajo e lëkurës së hollë që mbështjell thelbin e gështenjës. Sy gështenjë. Flokë gështenjë. Ngjyrë gështenjë.....</p> <p>3. bot. Dru i viseve malore, me trung të madh e me gjethe si heshtë, që bën fryte në trajtë kokrrash të vogla, të veshur me një lëkurë të ndritshme ngjyrëkafe e me një shark me gjemba; fryti i kësaj peme, i cili hahet. Gështenjë e butë. Gështenja të ziera (të pjekura). Dru gështenjë. Pyll gështenjash. Lëkura e gështenjës. Thelbi i gështenjës. Miell gështenjash. Qëroj</p>
<p>GROSHË <i>f.</i> (<i>white bean</i>)</p> <p>Fasule. Groshë të thata (të njoma). Groshë qorre. Groshë të kuqe. Groshë mishi. bised. mashurka. Groshë qeni. bised. fasule lara-lara.....</p>
<p>GJETH <i>m.</i> (<i>Leaf</i>)</p> <p>1. Gjethe. Gjethi i plepit. Gjethi i dushkut.</p> <p>2. përmb. Tërësia e gjetheve të pemëve a të bimëve. Çeli (doli) gjethi. I ra gjethi. Era e gjethit erë e lehtë pranverore që fryn në kohën kur çel gjethi.</p> <p>3. përmb. Degët e holla me gjethe të disa drurëve, që përdoren si ushqim për bagëtinë; ushqim prej bimësh për bagëtinë. Gjeth dushku. Bëjnë gjeth. Presin gjeth. Mullar me gjeth....</p>
<p>GJILPËRË <i>f.</i> (<i>NEEDLE</i>)</p> <p>1. Fill i hollë çeliku me majë të mprehtë e me vrimë në fund, që përdoret për të qepur; fill i tillë pa vrimë, që përdoret për t'u ngulur. Gjilpërë e hollë (e trashë). Gjilpërë qepëse. Gjilpërë kapëse karficë. Gjilpërë dore (makine). Maja (vrime) e gjilpërës. Jastëku i gjilpërave. Qep me gjilpërë. Shkoj perin në gjilpërë. Shpim me gjilpërë. akupunkturë.</p> <p>2. Shufër çeliku e hollë dhe me majë në një mekanizëm, e cila shërben për qëllime të ndryshme. Gjilpëra e pushkës (e topit). Gjilpëra e gramafonit. Gjilpëra e kompasit. Gjilpëra e sahatit. Susta e gjilpërës. ..</p> <p>3. Gyp shumë i hollë metalik me majë të mprehtë që vihet në shiringë e ngulet në trup për të futur një bar të lëngshëm për mjekim; bised. bari që futet në trup me këtë mënyrë.</p>

<p>Gjilpërë në damar. Gjilpërë kundër tetanosit. Bëri një gjilpërë. Ziej gjilpërat. Thith me gjilpërë.....</p>
<p>HAJDE <i>pasth. bised. (COME)</i> 1. përd. kallëzues. Eja. Hajde ditën! Hajde në mbrëmje! Hajde vetëm. Hajdeni me ne! 2. Përdoret kur thërresim, kur ftojme, kur nxitim dikë për të nisur një punë, për të bërë diçka etj; eja. Hajdeni, more shokë! Hajde të shkojmë. Hajde të bisedojmë! Hajdeni të këndojmë (të vallëzojmë,)! Hajde, gështenja të pjekura! Hajde, mos ki gajle! Hajde, se nuk të lëmë vetëm!</p>
<p>JUFKË <i>f. (pasta)</i> 1. kryes. Petë brumi të gatuar zakonisht me vezë, të thara në diell dhe të copëtuara, që përgatiten si zahire për dimër; petë, petarishte, petka. Jufka me gjalpë. 2. Ëmbëlsirë që bëhet me petë të pjekura në tigan dhe të përvëluara me sherbet; një lloj petulle me sherbet.</p>
<p>KANAL <i>m. (CHANNEL)</i> 1. Hendek i thellë e i gjerë, që është hapur për të ujitur, për të kulluar tokat, për të mbledhur ujërat etj.; shtrat i gjerë që është hapur për të lidhur dy lumenj ose dy dete. Kanal ujitës (kullues, ujëmbledhës). Kanal i lundrueshëm. Kanal nëntokësor rrjedhë uji nën tokë ose hapësirë ku kalon nafta, gazi etj. Kanal shkarkimi. Kanalet e rrugës. Kanali i ujërave të zeza. Kanali Peqin-Kavajë. Kanali i Suezit. .... 2. anat. Pjesë e një organi, në trajtë gypti të ngushtë me dredha, ku zakonisht kalojnë lëndë të ndryshme në organizëm. Kanali i ushqimit. Kanali i jashtëqitjes. Kanalet e lotëve. .... 3. tek. Gyp nëpër të cilin kalon një lëng ose gaz; vijë e thelluar, në trajtë lugu, në sipërfaqen e ndonjë vegle a pjese të një mekanizmi; vjaskë. Kanali i tytës. Kanal ajrimi. .... 4. gjeogr. Pjesë e ngushtë në det midis dy brigjeve të afërta. Kanali i Korfuzit. Kanali i Otrantos. 5. rad., televiz. Stacion; program që jepet me valë të veçanta. Kanali i parë (i dytë). 6. fig. Rrugë nëpërmjet së cilës plotësojmë një detyrë a kryejmë një punë, ia arrijmë një qëllimi ose lidhemi me dikë. Kanal diplomatik . Kanal i fshehtë. Kanalet e bashkëpunimit...</p>
<p>KARRIGE <i>f. (CHAIR)</i> 1. Ndenjëse për një njeri, me katër këmbë, me shpinëz dhe pa mbështetëse për krahët. Karrige lëvizëse (rrotulluese). Karrige kashte. Karrige elektrike ndenjëse që përdoret në vendet kapitaliste për të zbatuar dënimet me vdekje me anë të rrymës elektrike. Shpinëza e karriges. Rri (ulem) në karrige. 2. fig. keq., bised. Vend pune në zyrë, vend i rehatshëm pune. Ka zënë një karrige. * Rri (qëndron) mbi dy karrige keq, nuk është parimor dhe i qëndrueshëm në pikëpamjet e tij.</p>
<p>KROI <i>m. (fountain)</i> 1. Burim uji, që në vendin ku del rregullohet e pajiset zakonisht me një lug, me një lëfynt ose me ndonjë mur të posaçëm; gurrë, burim, vendi ku del burimi; uji i tij. Krua i ftohtë. Kroi i fshatit. Ujë kroi. Mbush ujë në krua. Pi ujë në krua. Lahem në krua. * Kemi pirë ujë në një krua jemi prej një vendi; jemi të afërt; e njohim mirë njëri-tjetrin. Ka pirë ujë në shumë kroje (burime) .....</p>

<p><b>KRIPË</b> <i>f. (KRIPË)</i></p> <p>1. Lëndë e bardhë dhe e fortë në trajtë kokrrizash të vogla të kristalta, e tretshme në ujë, me shije të njelmët, që nxirret nga uji i detit (nëpër kripore) a nga toka (në miniera) dhe që përdoret në gjelle ose u hidhet ushqimeve për t'i ruajtur për një kohë të gjatë. Kripë e bardhë kripë e pastruar mirë. Kripë gjellë. Kripë guri kripa që nxirret në miniera. Gjalpë (djathë, gjizë) me (pa) kripë. I hedh (i shtie) kripë gjellës. Vë (shtie) në kripë. E shoh gjellën për kripë. E ha me pak kripë. Për atë kripë! bet. vjet.</p> <p>2. kim. Përbërje kimike, formuar nga zëvendësimi i plotë a i pjesshëm i hidrogjenit të një acidi me metal e me njëvlerës të tij. Kripëra organike (joorganike). Kripëra minerale. Kripa e argjendit...</p>
<p><b>KULETË</b> <i>f. (WALLET)</i></p> <p>1. Qese e vogël prej lëkure, me disa të ndara, që mbahet me vete për të vënë të holla, letra me vlerë etj. Futi paratë në kuletë. Nxori letërnjoftimin nga kuleta.</p> <p>2. fig. bised. Paratë që ka dikush, të ardhurat; llogaria mbi të ardhurat dhe shpenzimet e përditshme; xhepi. Sipas kuletës sipas të ardhurave që ka. Kush e mban kuletën? I mban kuleta atij ka para. Shih kuletën tënde! E mbushi kuletën fitoi shumë para. E zgjidhi (e hapi) kuletën (qesen, trastën). .....</p>
<p><b>LART</b>. <i>I.ndajf. (up)</i></p> <p>1. Në largësi të madhe nga tokaose nga një sipërfaqe tjetër në derjtim pingul; në hapësirën mbi tokë; më sipër se diçka tjetër ose se zakonisht ; në drejtim pingul duke u nisur nga poshtë përpjetë; drejtë përpjetë; <i>kund.ulët, poshtë, . Lart e më lart. Fluturon lart. Nga poshtë lart. U ngjit lart. E mban kokën lart.</i></p> <p>2. Sipër mbi diçka; në një vend të ngritura mbi një mjet; në pjesën e mësipërme; <i>kund. poshtë. Lart mbi mur (në çati). Lart në katin e dytë. Lart në pemë (në mal). Lart në kalë. ....</i></p>
<p><b>LLAMBË</b> <i>f. (LAMP)</i></p> <p>1. Mjet ndriçimi me vajguri a me një lëndë djegëse tjetër dhe me fitil, që mbulohet me një poç të gjatë prej qelqi; mjet i vogël ndriçimi me bateri; mjet nxehjeje me fitil dhe zakonisht me alkool. Llambë me vajguri (me benzinë). Llambë me alkool. Llambë karbiti. Llamba e shtëpisë. Llamba e minatorit. Drita e llambës. Poçi (qelqi) i llambës. Ndez (shuaj, fik) llambën.</p> <p>2. Pajisje prej qelqi, e rrumbullakët ose gjatoshe, zakonisht me fije metalike brenda a me gaz, që ndriçon me rrymë elektrike ose përdoret për punë të veçanta në aparate të ndryshme. Llambë elektrike. Llambë neoni. Llambë elektronike. Llambat e radios. Llambë automjetesh.</p>
<p><b>MAKINË</b> <i>f. (CAR -machine)</i></p> <p>1. Mjet i përbërë nga një tërësi pjesësh a veglash, që vihet në lëvizje me rrymë elektrike ose me lëndë djegëse dhe që shërben për të kryer një punë të caktuar, për të nxjerrë një prodhim duke përpunuar lëndë të parë, për të shndërruar një lloj energjie në një lloj tjetër etj.; mjet i përbërë prej disa pjesësh që vihet në veprim zakonisht me dorë për punë të ndryshme. Makinë bujqësore. Makinë mbjellëse (korrëse, shirëse, kositëse, grirëse). Makinë qepëse. Makinë larëse (tharëse, fshirëse). Makinë llogaritëse. Makinë elektrike (kibernetike). Makinë me avull (me motor). Makina e blojës. Makinat e tezgjahut (e</p>

<p>ngjyrosjes). Makinë shkrimi. Makinë rroje. Makinë për grirjen e mishit. Prodhimi i makinave.</p> <p>2. bised. Automobil, automjet. Makinë e re (e vjetër). Makinë ushtarake (civile). .....</p>
<p>MIELL <i>m. (flour)</i></p> <p>1. Pluhur i imët, që bëhet duke bluar drithin dhe që përdoret për të bërë bukë e për gatesa të tjera. Miell i hollë (i imët, i trashë). Miell i bardhë (i verdhë). Miell gruri (misri, orizi). Maja e miellit. Fabrika e miellit. Një dorë miell. Sit miellin. I butë si miell. Nuk mbahet shtëpia me miell hua. fj. u.</p> <p>2. Pluhuri që del kur thërrmohen imët, bluhen ose përpunohen disa lëndë. Miell patatesh (salepi). Miell mishi (peshku). Miell gjaku (qumështi). Miell kockash (eshtrash). Miell druri (sharre). Miell guri (tullash). Miell bari (jonxhe, rrënjash).. .....</p>
<p>MIK <i>m. (friend , buddy)</i></p> <p>1. Ai me të cilin kemi miqësi; ai që na do të mirën, na ndihmon me gjithë zemër e na gjendet në çdo nevojë; një i njohur, me të cilin kemi lidhje të ngushta, njeri i afërt; kund. armik. Mik i ngushtë (i vërtetë). Mik i rremë. Mik i vjetër. Mik me (për) kokë mik shumë i dashur e i ngushtë. Mik për fiq. bised. ai që shtihet si mik i dikujt për të nxjerrë përfitime prej tij, mik i rremë. Mik i familjes (i shtëpisë) njeri shumë i afërt i familjes. E kam mik. Miku i mirë njihet në të vështirë. fj. u. Më mirë një mikse një çiflig. fj. u. Mikut ankoju, armikut lëvdoju.....</p> <p>3. Mysafir që vjen për të bujtur në shtëpi; ai që ftohet për të marrë pjesë në një festë etj. Mik i i largët.</p>
<p>MISËR <i>m. (corn)</i></p> <p>Bimë njëvjeçare me kërcell të fortë e të gjatë si kallam, me gjethe të mëdha heshtore, që nxjerr në majë lule si tufë, bën kallinj të mëdhenj, me koçan të fortë, të mbështjellë me fletë të gjelbra e me kokrra të bardha a të verdha dhe mbillet si drithë; kokrrat e këtij drithi, që bluhen miell për bukë a për gatesa të ndryshme ose hahen të ziera a të pjekura, përdoren si ushqim për bagëtinë, për të nxjerrë prej tyre vaj etj. Misër i bardhë (i verdhë). Misër i hershëm (i vonë). Misër hamullor misër që mbillet në toka ku janë korrur të lashtat.</p>
<p>NËNË <i>f. (MOTHER)</i></p> <p>Gruaja kundrejt fëmijëve të vet; grua që ka lindur fëmijë, mëmë. Nënë e dashur (e dhembshur, e kujdesshme). Nënë e lumtur. Nënë dëshmori. Nënë me shumë fëmijë. Zemër (dhembshuri) nëne. Qumështi i nënës. Dera (shtëpia) e nënës. Gjuha e nënës gjuha amtare. U bë nënë lindi fëmijë. Të pastë nëna! ur. Fëmija pa nënë, si nata pa hënë fj. u.</p>
<p>OBORR <i>m. (yard)</i></p> <p>1. Vend përpara ose prapa shtëpisë, i rrethuar me mur a me gardh; shesh, zakonisht i shtruar me pllaka guri etj. ndërmjet dy a më shumë ndërtesave. Oborr i brendshëm. Oborr i shtruar. Oborri i shtëpisë (i shkollës). Oborret e ndërtesave. Oborr me lule. Muret (dera) e oborrit. Shtëpi me oborr. Rri në oborr.</p> <p>2. Oborri kooperativist. Bagëtitë e oborrit.</p> <p>3. Pallati i mbretit a i perandorit së bashku me pjesët plotësuese; përmbi. tërësia e njerëzve të shtresave të larta që mban rreth vetes monarku, rrethi i ngushtë i mbretit a i perandorit. Oborri mbretëror (perandorak).</p>



<p>ORË <i>f. (hour)</i></p> <p>1. Njësi kohe që është e barabartë me një të njëzetekatërtën pjesë të ditës e të natës dhe që ka gjashtëdhjetë minuta. Një gjysmë (një çerek) ore. Dita ka dymbëdhjetë orë. Punoj tetë orë. E bëri rrugën për gjashtë orë. Fluturon me shpejtësi tetëqind kilometra në orë. U mbush një orë. Erdhi pas dy orësh. U vonua një orë e gjysmë. Kaluan tri orë. Paguhet me orë.</p> <p>2. Kohë prej dyzetepesë ose gjashtëdhjetë minutash, gjatë së cilës bëjmë diçka, pushojmë etj.; kohë e tillë që përdoret për një mësim dhe që shërben si njësi për të caktuar ngarkesën mësimore të mësimdhënësit. Orë mësimore (ora e mësimit). Orë akademike kohë prej rreth pesëdhjetë minutash. ... Orë pushimi (çlodhjeje).</p> <p>3. astr. Njësi kohe, që përcaktohet për të llogaritur lëvizjen sipas rrotullimit të Tokës ose të një trupi tjetër qiellor. Orë diellore. Orë hënore. Orë astronomike kohë e përpiktë, që përcaktohet me vrojtime të veçanta, duke marrë si bazë meridianin e Grinuiçit. ....</p>
<p>PATATE <i>f. bot. (potato)</i></p> <p>Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe me push nga poshtë e me lule të bardheme, e cila mbillet zakonisht në toka të shkrifëta dhe bën zhardhokë që përmbajnë shumë niseshte e përdoren gjerësisht si ushqim etj.; zhardhokët e kësaj bime. Patate e ëmbël lloj patateje me tul shumë të ëmbël. Patate e kuqe lloj patateje me zhardhokë gjatoshë, që e kanë lëkuren si të kuqe. Patate e verdhë lloj patateje që e ka lëkurën në ngjyrë të verdhë të zbehtë. Patate verore. Patate të hershme (të vona). Patate të ziera (të skuqura, të fërguara, të pjekura). Kokrra patatesh. Niseshte (miell) patatesh. Qofte (pure) patatesh. Gjellë (tavë, mish) me patate. Dy thasë me patate. Buburreci (vrugu) i patates. zool. Mbjellin (shkulin) patate. ....</p>
<p>PASQYRË <i>f. (looking glass)</i></p> <p>1. Fletë xhami e lyer nga njëra anë me një shtresë të hollë të një përzierjeje argjendi, kallaji, zhive etj., që ka vetinë të kthejë rrezet e dritës dhe të japë të plotë shëmbëllimin e çdo gjëje që ndodhet përpara; sipërfaqe metalike e lëmuar, që ka këtë veti. Pasqyrë e rrafshët. Pasqyrë muri. Pasqyrë xhepi. Shihet në pasqyrë. Qëndron përpara pasqyrës. Ndrin si pasqyrë.</p> <p>2. Sipërfaqe e rrafshët e ujit etj., që e kthen dritën. Përmbi pasqyrën e detit.</p> <p>3. Listë a tabelë përmbledhëse, që përmban një varg të dhënash, emrash etj. Pasqyrë e shkurtër (përmbledhëse). Pasqyrë statistikore. Pasqyra e notave. ....</p>
<p>PESHQIR <i>m. (TOWEL)</i></p> <p>Copë e trashë katërkëndëshe prej pambuku, e butë, me push e me thekë, që e përdorim për të fshirë fytyrën, duart a trupin pasi lahemi. Peshqir i butë (i ashpër). Peshqir i madh (i vogël). Peshqir me vija (me lule, me thekë). Peshqir duarsh. I fshij duart (këmbët) me peshqir. Mbështjell kokën (qafën) me peshqir. ....</p>
<p>PILAF <i>m. (pilau)</i></p> <p>Gjellë e përgatitur vetëm me oriz, i cili zihet në ujë a në lëng mishi, bëhet i thatë e i shkrifët e përvëlohet me gjalpë; sasi nga kjo gjellë sa nxë një pjatë. Pilaf me kimë (me salcë, me djathë). Pilaf me kos.</p>
<p>PLUHUR <i>m. (DUST)</i></p> <p>1. Dhe i tharë e i thërrmuar shumë imët, që formohet zakonisht në verë nëpër rrugë, nëpër fusha etj. ngrihet lehtë në ajër ose mbulon sipërfaqet e sendeve të ndryshme; lëndë tjetër e</p>

<p>ngurtë, e thërrmuar hollë si hi. Pluhur i imët. Pluhur radioaktiv. Pluhur rëre (guri, shkumësi). Pluhur druri (sharre) tallash. Pluhur metali . Pluhuri i letrës. Pluhur qymyri (gëlqereje, duhani). .....</p>
<p><b>QEN</b> <i>m. (DOG)</i> 1. zool. Kafshë gjitare shtëpiake, mishngrënëse, me trup mesatar, që ka nuhatje shumë të mirë, që afrohet shpejt me njeriun dhe që mbahet për të ruajtur shtëpinë, bagëtinë etj., për gjah e për punë të tjera. Qen i bardhë (i zi). Qen besnik. Qen i tërbuar. Qen stani. Qen bariu. Qen gjuetie lingua, zagar. Qen kufiri. ....</p>
<p><b>QERSHI</b> <i>f. bot. (CHERRY)</i> Dru frutor me gjethe vezake të dhëmbëzuara, me lule të bardha të grumbulluara tufë, që bën kokrra të kuqe a të verdha, të ëmbla e me bërthamë në mes, të cilat piqen në fillim të verës; kokrrat e kësaj peme që përdoren për të ngrënë a për reçel. Qershi e butë (e egër). Qershi belica. Qershi gurje (krapje). Kokrra qershie. Bishtat e qershive. Lëng (reçel) qershie. Druri i qershisë. Vjel qershitë.....</p>
<p><b>QILIM</b> <i>m. (CARPET)</i> 1. Shtrojë me përmasa të ndryshme dhe me një a me disa fletë, e punuar në vegjë me fije të trasha leshi, pambuku etj., zakonisht me disa ngjyra e me zbukurime, që vihet mbi dysHEME ose varet në mur si stoli. Qilim i vogël (i madh, i trashë, i rrahur, i shkelur). Qilim me vija (me lule). Qilim me thekë (me push). Qilim me lecka. Qilim muri. Fletët e qilimit. Ndërmarrja e qilimave. Shtroj (hap, ngre, mbledh, shkund) qilimin. 2. fig. Shtresë e pandërprerë dhe e butë që mbulon një truall të gjerë. Qilim dëbore. Qilim bari. Qilim lulesh. * Qilimi i gjelbër libr. fusha e futbollit.</p>
<p><b>QUMËSHT</b> <i>m. (MILK)</i> 1. Lëng i bardhë e si i ëmbël që nxjerrin pas lindjes gjëndrat e gjirit të gruas e të femrave të gjitarëve si ushqim për të vegjlit e tyre. Qumështi i parë kulloshtër. Qumësht gjiri. Qumështi i nënës. Gjëndrat e qumështit.. I erdhi (i iku, iu pre) qumështi. Ia preu qumështin fëmijës nuk i jep më të pijë nga gjiri. Motër (vëlla) qumështi motër (vëlla) nga e njëjta nënë. 2. Lëng i bardhë, që merret nga gjiri i disa kafshëve shtëpiake dhe që përdoret nga njeriu si ushqim me vlerë të madhe. Qumësht i hollë (i trashë, i lyrshëm). Qumësht i rrahur. Qumësht i zier (i pazier, i nxehtë, i ftohtë). Qumësht dhensh. Qumësht i dhirtë qumësht dhish. Qumësht lope (deleje, dhie, pele, buallice).</p>
<p><b>QYTET</b> <i>m. (city)</i> 1. Qendër e madhe banimi, me shumë shtëpi të ndara zakonisht në lagje, me rrugë e me sheshe të rregulluara, ku zhvillojnë veprimtarinë e tyre një varg institucionesh politike, shoqërore, administrative, kulturore etj. dhe ndërmarrjesh industriale, tregtare etj. Qytet i madh (i vogël). Qytet i ri (i lashtë, mesjetar). Qytet ilir. Qytet kryesor. Qytet bregdetar (malor). Qytet industrial. Lagjet (rrugët, sheshet) e qytetit.....</p>
<p><b>SAKSI</b> <i>f. (flowerpot)</i> Enë e vogël prej balte me fund më të ngushtë se kreu, e cila përdoret për të mbjellë e për të rritur lule; vazo lulesh. Saksi me lule. Saksitë e dritareve (e oborrit). Karafil (borzilok) në saksi. I ka mbjellë në saksi. Ujit saksitë.</p>

<p><b>SOBË</b> <i>f.</i> (<i>STOVE</i>)</p> <p>1. Pajisje për të ngrohur një dhomë ose për të gatuar, zakonisht në trajtën e një kutie të madhe prej metali, prej balte etj., me vendin për të ndezur zjarrin dhe me qyngjet për të tërhequr tymin; stufë. Sobë ekonomike sobë e madhe për të gatuar dhe me furrë për të pjekur. Sobë me dru (me gaz, me qymyr). Sobë për ngrohje.</p> <p>2. krahin. Dhomë në katin e parë, ku në dimër ndizet zjarri vazhdimisht. Rrinë në sobë.</p>
<p><b>SPEC</b> <i>m.</i> (<i>pepper</i>)</p> <p>1. bot. Bimë barishtore e butë me kërcell të degëzuar, me gjethe vezake, me lule të vogla të bardha, që bën fryte të fryra me lëkurë mishtake në ngjyrë të gjelbër, të verdhë a të kuqe me fara brenda dhe është një nga perimet me të përhapura; frytet e kësaj bime që përdoren për ushqim; piperkë. Spec i kuq. Spec djegës. ....</p> <p>2. Pluhur i kuq nga frytet e thara e të grira imët të një lloji të veçantë të kësaj bime me kokrra të vogla, të kuqe e shumë djegëse, i cili i hidhet gjellës; piper i kuq. Spec i kuq.</p>
<p><b>SPITAL</b> <i>m.</i> (<i>HOSPITAL</i>)</p> <p>Qendër e posaçme me mjekë, me shtretër dhe me pajisjet e nevojshme, ku shtrohen dhe mjekohen ata që vuajnë nga sëmundje të ndryshme; ndërtesa e kësaj qendre. Spital civil (ushtarak). Spital i përgjithshëm. Spitali i fëmijëve. Ndërtesa e spitalit. Drejtori i spitalit. Mjekët e spitalit. U shtrua në spital. Doli nga spitali.</p>
<p><b>STILOLAPS</b> <i>m.</i> (<i>PEN</i>)</p> <p>Lloj lapsi që shkruan me bojë, i përbërë nga një gyp i hollë i mbushur me bojë të trashë dhe nga një majë prej metali; laps që shkruan si stilograf. Rezervë (zemër) stilolapsi. Shtyp sustën e stilolapsit.....</p>
<p><b>SY</b> <i>m.</i> (<i>eye</i>)</p> <p>1. Organi i të parit te njeriu dhe te kafshët, që ndodhet në pjesën e përparme të kokës ose anash saj. Syri i djathtë (i majtë). Me sy të mëdhenj (të vegjël). Me sy të zinj (gështenjë, të kaltër). Me sy të dalë (të kërcyer, të futur). Me sy të skuqur (të përlotur, të përgjumur). Me sy hapur (mbyllur). Sy xhami (i vënë, artificial)</p>
<p><b>SHALQI</b> <i>m. bot.</i> (<i>watermelon</i>)</p> <p>Bimë njëvjeçare me kërcell të gjatë e të shtrirë përtokë, me gjethe si pëllëmbë, që bën kokrra të mëdha, të rrumbullakëta ose vezake; kokrra e kësaj bime me lëkurë të trashë, të gjelbër ose laramane, e me tul të kuq, të lëngshëm e të ëmbël, i cili hahet. Shalqi farëvogël (farëmadh). Shalqi laraman. Shalqi vendi. Zemra e shalqirit. Thelë shalqiri. Fara shalqiri.</p>
<p><b>SHI</b> <i>m.</i> (<i>rain</i>)</p> <p>1. Reshje që formohet nga kthimi i avujve të atmosferës në ujë gjatë ftohjes dhe që bie pika-pika nga retë në tokë. Shi i madh (i rrëmbyer, i rëndë, i hollë, i shtruar, i lehtë, i imët). Shi tropikal. Shirat e vjeshtës (e pranverës, e dimrit). Shi vere (behari). Shi me kufi (vendevende). Shi me borë. Shi me shtamba. Ujë shiu. Pika shiu. Një vesë shi. Ditë me shi. ....</p>
<p><b>SHPORET</b> <i>m.</i> (<i>kitchen range</i>)</p> <p>1. Sobë kuzhine, stufë, kuzhinë ekonomike. Pjek në shporet.</p>
<p><b>SHTËPI</b> <i>f.</i> (<i>HOUSES</i>)</p> <p>Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje a për familje të një gjaku); banesë; apartament ku banon një familje. Shtëpi e madhe (përdhes, dykatëshe, elbasançe)! Shtëpia</p>

<p>jonë. Shtëpi fshati. Shtëpi me gurë (me tulla, me qerpiç). Shtëpi me dy (tre) kate. Shtëpi me avlli. Shtëpi me qira. Një shtëpi këtu, një atje.</p>
<p>TAVOLINË <i>f. (table)</i> Tryezë. Tavolinë buke (pune, shkrimi). Tavolinë shahu. Mbulesë (mushama) tavoline. U ulën rreth (pranë) tavolinës.</p>
<p>TELEKOMANDIM <i>m. spec. (a remote control device)</i> Veprimi sipas kuptimeve të foljeve TELEKOMANDOJ, TELEKOMANDOHEM. Aparate (mjete) telekomandimi. Me telekomandim nga toka.</p>
<p>TYM <i>m. (fume)</i> Pjesa e gaztë, e përzier me avuj, me thërrmija bloze, hiri etj., zakonisht në ngjyrë të zezë ose të hirtë, që del kur digjen drutë, letrat a ndonjë lëndë tjetër dhe që ngrihet lartë si re. Tym i zi (i bardhë, i verdhë). Tym i dendur (i trashë). Tym i lehtë. Tymi i oxhakut. Tymi i kandilit (i pishës). Tymi i cigares. Tymi i barutit.</p>
<p>VAJZË <i>f. (GIRL)</i> Fëmijë femër; njeri i seksit femëror deri në moshën e pjekurisë; femër që s'është martuar; çupë. Vajzë e bukur (e zgjuar, e shkathët). Vajzë trime. Vajzat shqiptare. Vajzat aksioniste. Vajzë punëtore. Vajzë lozonjare. Vajzë e përkëdhelur. Vajzë e lashtë lëneshë. Vajzat e fshatit (e kooperativës).</p>
<p>VETËTIMË <i>f. (thunderbolt)</i> 1. Dritë e fortë që flakëron për një çast e me shpejtësi të madhe në qiellin me re, zakonisht në trajtë vijash zigzage a të degëzuara, e cila shkaktohet nga shkarkimet elektrike në atmosferë; shkrepTIME. Në dritën e vetëtimës. Me shpejtësi vetëtime. Shkrepi vetëtima. Shkoi si vetëtima shkoi shumë shpejt. 2. Rrufe. E vraftë vetëtima! mallk.</p>
<p>VETURË <i>f. (CAR)</i> Automjet i vogël udhëtimi me katër rrota dhe zakonisht për katër veta. Veturë sportive. Udhëtoi me veturë. Hipi në veturë. Zbriti nga vetura.</p>
<p>XHAXHA <i>m. (UNCLE)</i> Vëllai i babait kundrejt nipit e mbesës. Xhaxhai i madh (i vogël). Vajza e xhaxhait. E kam xhaxha. Shkoi ndër xhaxhallarë.</p>
<p>XHAKETË <i>f. (JACKET)</i> Pjesë e sipërme kostumit, me mëngë, me jakë të kthyer, që përpara është e hapur e mbërthehet me kopsa dhe që vishet zakonisht mbi këmbë. Xhaketë e hapur (e mbyllur). Xhaketë e shkurtër (e gjatë). Xhaketë sportive xhaketë shumë e hapur përpara. Xhaketë ushtarake. Xhaketë verore. Xhaketë e lehtë.</p>

Creative Commons licensing terms

Author(s) will retain the copyright of their published articles agreeing that a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY 4.0) terms will be applied to their work. Under the terms of this license, no permission is required from the author(s) or publisher for members of the community to copy, distribute, transmit or adapt the article content, providing a proper, prominent and unambiguous attribution to the authors in a manner that makes clear that the materials are being reused under permission of a Creative Commons License. Views, opinions and conclusions expressed in this research article are views, opinions and conclusions of the author(s). and European Journal of Literature, Language and Linguistics Studies shall not be responsible or answerable for any loss, damage or liability caused in relation to/arising out of conflicts of interest, copyright violations and inappropriate or inaccurate use of any kind content related or integrated into the research work. All the published works are meeting the Open Access Publishing requirements and can be freely accessed, shared, modified, distributed and used in educational, commercial and non-commercial purposes under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License \(CC BY 4.0\)](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/).